



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/1188 Dt.28/09 /2017

Këshilli Drejtues i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në mbledhjen e XVII të radhës, të mbajtur më 11.09.2017, miratoi këtë:

Rregullore
për zgjedhjet e Studentëve të UKZ

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton procedurën dhe organizimin e zgjedhjeve për anëtarët e parlamentit të studentëve dhe të këshillave të studentëve të fakulteteve.

Neni 2

Studentët e rregullt dhe me korrespondencë të studimeve baçelor kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore në kuadër të UKZ-së.

Studentëve të studimeve Master, u njihet e drejta e votës, dhe e drejta në zgjedhjen e organeve përfaqësuese.

Secila organizatë studentore duhet të ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj dhe në pajtim me këtë rregullore.

Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.



Neni 3

- (1) Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitetet përmes këtyre organeve:
1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit.
 2. Këshillat e studentëve në nivel të secilës njësisë akademike.
 3. Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
 4. Studentët të cilët kanë të përsëritur vite të studimeve nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjidhen në pozita udhëheqëse studentore në UKZ.
 5. Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk mund të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore.

Parlamenti i Studentëve

Neni 4

- (1) Parlamenti i studentëve është organ suprem i përfaqësimit të studentëve.
- (2) Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarin e Senatit nga lista e të propozuarve, e përgatitur nga këshillat e studentëve të secilës njësi akademike, kurse kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar i senatit me automatizëm.
- (3) Parlamenti i studentëve duhet të fokusohet në temat si në vijim:
- Interesat e studentëve në nivel të Universitetit;
 - Angazhimi për cilësinë në mësimdhënie dhe mësimxënie;
 - Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të Universitetit dhe zhvillimet akademike;
 - Zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
 - Bursat universitare;
 - Ndihmat (bursat) sociale;
 - Çështjet tjera të përgjithshme të interesave të studentëve;
 - Organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive.
- (4) Parlamenti i studentëve merr vendimet si në vijim:
- Zgjedhjen e një anëtari-studentë në Senatin e UKZ-së; (plus kryetar i parlamentit të studentëve)
 - Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të UKZ-së;
 - Propozimet për Senatin e UKZ-së, në lidhje me çështjet studentore dhe akademike;
 - Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e UKZ-së ku studentët janë anëtarë sipas statutit;
 - Çështjet tjera të ngjashme



Neni 5

- (1) Numri i anëtarëve të parlamentit të studentëve është nga 2 (dy) kandidatë për çdo njësi akademike dhe kryetari i Parlamentit Studentor.
- (2) Anëtarët e parlamentit të studentëve do të zgjidhen nga zgjedhjet e përgjithshme të Universitetit, ku secila organizatë studentore e cila është certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje, do të bëj fushatë në bazë të listës së kandidatëve.
- (3) Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga numri i përgjithshëm i përqindjes së votave që arrihet gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.
- (4) Zgjedhjet e parlamentit studentor do të udhëhiqen nga komisioni zgjedhor.

Këshilli i studentëve

Neni 6

- (1) Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.
- (2) Secili këshill i studentëve propozon nga tre kandidat për anëtarë studentë të Senatit për tu zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
- (3) Kryesuesi i këshillit të studentëve është anëtari student i këshillit të fakultetit.
- (4) Secili këshill i studentëve duhet të fokusohet në temat si në vijim:
 - Interesat e studentëve në nivel të njësisë akademike;
 - Studimet që ndërlidhen me aspektet e reformave të fakultetit dhe zhvillimet akademik;
 - Zhvillimi i cilësisë së mësimit dhe të vlerësimit;
 - Bursat universitare;
 - Ndihmat (bursat) sociale;
 - Çështjet tjera të ngjashme.
- (5) Secili këshill i studentëve merr vendime si në vijim:
 - Përgatitjen e listës së ngushtë për anëtarët-studentë të Senatit;
 - Zgjedhjet e anëtarëve-studentëve të këshillave të fakultetit;
 - Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të fakultetit;
 - Propozimet për këshillin e fakultetit lidhur me çështjet studentore dhe akademike;
 - Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e fakultetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit;
 - Çështjet tjera të ngjashme.



Neni 7

- (1) Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me se paku 5 e më së shumti 21 anëtarë. Në rast se një njësi akademike ka me pak se 300 studentë, këshilli i studentëve do të ketë 5 anëtarë.
- (2) Përfaqësimi i studentëve në këshillin studentor do të jetë në bazë të përqindjes së numrit të studentëve sipas nivelit të studimeve bachelor.
- (3) Anëtarët e këshillave të studentëve do të zgjidhen individualisht përmes zgjedhjeve në secilën njësi akademike, ku secila organizatë studentore e pranueshme do të bëjë fushatë në bazë të listës së kandidatëve.
- (4) Ndarja e mandateve për secilën organizatë studentore që bën fushatë, varet nga totali i përqindjes së votave të arritura gjatë zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.
- (5) Zgjedhjet për këshilla të studentëve do të udhëhiqen nga komisioni përkatës i fakultetit në bashkëpunim me komisionin zgjedhor.

Parimet e zgjedhjeve

Neni 8

- (1) Regjistrimi i organizatave të reja do të bëhet në Ministrinë e Administratës Publike, konform Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
- (2) Universiteti “Kadri Zeka” do t’i certifikojë vetëm ato organizata të cilat do të regjistrohen në kuadër të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.
- (3) Në përbërjen e të gjitha strukturave vendimmarrëse duhet të jenë studentë të UKZ.
- (4) Organizatat e themeluara duhet të regjistrohen së paku 3 javë para datës së zgjedhjeve.
- (5) Organizatat studentore kanë të drejtë të regjistrohen për:
 - a. përfaqësim të përgjithshëm të studentëve të universitetit;
 - b. përfaqësim të studentëve në fakultete individuale.
- (6) Numri minimal i deklaratave mbështetëse nënshkruese i nevojshëm për organizatat studentore për të arritur pranueshmërinë duhet të përcaktohet sipas rregullave të kësaj rregulloreje.
- (7) Organizata studentore për t’u regjistruar duhet t’i siguroi 150 nënshkrime mbështetëse kurse 50 nënshkrime për ata që garojnë vetëm për këshill të



fakulteteve.

- (8) Në deklaratën mbështetëse duhet të shënohet: Emri dhe mbiemri, numri i indeksi, Fakulteti, Departamenti dhe nënshkrimi.
- (9) Në rast se konstatohen parregullsi në plotësimin e shënimeve Komisioni Zgjedhor mund të anulojë regjistrimin e organizatës.
- (10) Data kualifikuese për organizatat studentore, për të fituar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore, do të caktohet 15 ditë para ditës së zgjedhjeve.
- (11) Procesi i regjistrimit dhe licencimit duhet të përfundojë në atë datë.

Neni 9

- (1) Anëtarët e parlamentit të studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjedhën në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.
- (2) Përfaqësimi i studentëve në parlamentin studentor do të jetë në bazë të përqindjes së numrit të studentëve sipas nivelit të studimeve baçelor.
- (3) Gjatë zgjedhjeve do të aplikohet sistemi i përfaqësimit proporcional. Kjo siguron që secila organizatë studentore që ka fituar numrin e përgjithshëm të votave mbi pragun përkatës të arritur, do të fitojë numrin e ulëseve në proporcion me përqindjen e votave të cilat ata i kanë marrë.
- (4) Limiti (pragu) për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
 - 5% i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e studentëve.
 - Për këshillat e fakulteteve të njësive akademike, minimumin prej 3% i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të njësisë përkatëse akademike.

Neni 10

Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe i këshillit të studentëve të njësive akademike zgjat 2 vjet.

Neni 11

- (1) Zgjedhjet e studentëve shpallen nga Këshilli Drejtues i UKZ-së.
- (2) Zgjedhjet e studentëve mbahen brenda 45 ditësh pasi të shpallen zgjedhjet nga Këshilli Drejtues i UKZ-së. Data e saktë përcaktohet nga Këshilli Drejtues i UKZ-së.



- (3) Organizatat e studentëve që fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjet studentore në nivel universiteti apo fakulteti duhet të mbajnë fushatën bazuar në listën prioritare të kandidatëve,
- (4) Periudha e fushatës zgjedhore për organizatat e studentëve do të fillojë në ditën e shpalljes së zgjedhjeve dhe do të përfundojë 48 orë para datës së zgjedhjeve, duke llogaritur kohën që nga ora 00:00 e ditës së shpalljes së zgjedhjeve. Zgjedhjet do të monitorohen nga Komisioni Zgjedhor dhe, shkeljet eventuale të rregullave zgjedhore do të sanksionohen.

Komisioni zgjedhor dhe komisionet e fakultetit

Neni 12

- (1) Komisioni Zgjedhor duhet të themelohet nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues brenda pesë ditëve pas datës kur të jenë shpallur zgjedhjet e studentëve. Kryesuesi i Komisionit Zgjedhor merr përsipër udhëheqjen pas zgjedhjes së tij/saj.
- (2) Komisioni zgjedhor përbëhet nga anëtarët si në vijim:
 1. Sekretari i Përgjithshëm i UKZ-së;
 2. një përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me kompetencat përkatëse ligjore;
 3. nga një përfaqësues prej të tri organizatave më të mëdha të studentëve, duke marrë për bazë numrin e fituar të votave në zgjedhjet e fundit. Nëse numri i organizatave pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit është më i vogël se tre, atëherë në bazë të nënshkrimeve të mbledhura të studentëve për organizatën mbështetëse.
 4. një përfaqësues i KQZ të Republikës së Kosovës, në cilësi të monitoruesit.
- (3) Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të dërgojë kërkesë me shkrim për të marrë emrat e nominuar nga organizatat nominuese sipas paragrafit (2) të këtij neni në afat tre ditor pas shpalljes së zgjedhjeve, kjo shkresë duhet të iu dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim të kryesuesi i Këshillit Drejtues më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstituiu. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave. Mbledhjen konstitutive e fillon kryetari i Këshillit
- (4) Komisioni zgjedhor e zgjedh kryetarin dhe zëvendës kryetarin me shumicë votash.
- (5) Kryetari zgjidhet nga mes i anëtarëve të renditur në pikat 1 dhe 2 të paragrafit (2) të këtij Neni. Zëvendës kryetari zgjidhet nga mes i anëtarëve studentë.
- (6) Komisioni zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore.
- (7) Rezultatet e zgjedhjeve shpallen ekskluzivisht nga komisioni zgjedhor.



- (8) Komisioni Zgjedhor duhet të aprovojë rregulloren e punës të komisionit zgjedhor, komisioneve të fakulteteve dhe udhëzimet për votim me propozim të kryesuesit të komisionit brenda 2 javëve pas konstituimit.

Neni 13

- (1) Për secilin fakultet të UKZ-së, duhet të themelohet komisioni i zgjedhjeve nga komisioni zgjedhor brenda pesë ditëve pas themelimit.
- (2) Komisioni i fakultetit përbëhet nga anëtarët si në vijim:
1. nga një përfaqësues prej të dy organizatave më të mëdha të studentëve, sipas nënshkrimeve të mbledhura.
 2. Një staf jo akademik (ne mungese te stafit jo akademik mund të caktohet staf akademik)
 3. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te kryesuesi i Komisionit Zgjedhor më së voni një ditë para mbajtjes së takimit konstituiv. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave.
- (3) Një staf jo akademik apo akademik i njësisë duhet të veprojë si kryetar i komisionit të fakultetit. Zëvendës kryetari zgjedhet nga mes i anëtarëve studentë me shumicë votash.
- (4) Komisioni i fakultetit është i obligua që të mbështesë komisionin zgjedhor në përgatitjen, udhëheqjen dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në fakultetin përkatës.

Neni 14

- (1) Asnjë student nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një zgjedhjeje apo komisioni të fakultetit.
- (2) Asnjë student nuk ka të drejtë që emri i tij të jetë në më shumë se në një listë të kandidatëve.
- (3) Asnjë student i cili/cila është anëtar i një zgjedhjeje apo komisioni zgjedhor nuk ka të drejtë të mbështes listën e kandidatëve apo anasjelltas.
- (4) Të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor dhe të komisioneve të fakultetit duhet të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim, e cila përgatitet nga kryesuesi i komisionit zgjedhor e cila thotë se ata/ato do të punojnë gjatë mandatit të tyre me përpikëri në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegje të plotë.
- (5) Këshilli Drejtues ka të drejtë që përkohësisht të suspendoj anëtarët student të zgjedhjeve apo komisionit të fakultetit me rekomandim të kryesuesit të komisionit



zgjedhor në rast të ndonjë shkelje të dëshmuar të rregullave të kësaj rregullore nga anëtarët përkatës. Në këtë rast pozita nuk do të ri-plotësohet për periudhën gjatë suspendimit.

Neni 15

- (1) Kryetari i komisionit zgjedhor është përgjegjës për:
 - Thirrjen e takimeve të komisionit zgjedhor;
 - Udhëheqjen e takimeve;
 - Udhëzimin për procesin e vendim marrjes;
 - Përgatitjen e procesverbalit të takimeve;
 - Ekzekutimin e vendimeve të komisionit zgjedhor;
 - Koordinimin e komisioneve të fakulteteve.
- (2) Kryetari të komisionit zgjedhor mund t'i caktohen deri dy bashkëpunëtor që do ta ndihmojnë në kryerjen e punëve teknike, logjistike dhe operacionale.
- (3) Rektori është i obliguar që të ofrojë mbështetje të mjaftueshme administrative për kryesuesin e komisionit zgjedhor në mënyrë që ti përmbushë obligimet e përshkruara nga kjo Rregullore sipas periudhave.
- (4) Në rast se kryetari mungon, përgjegjësitë sipas paragrafit (1) të këtij Neni do ti marrë zëvendës kryesuesi.

Neni 16

Secila organizatë e studentëve që kualifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, dhe e cila nuk është e përfaqësuar në komisionin zgjedhor apo në komisionet e fakultetit, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në komisionin zgjedhor.

Neni 17

- (1) Në rast të dorëheqjes së hershme të anëtarëve ashtu si janë listuar, Komisioni Zgjedhor duhet të kërkojë nga organizata deleguese të caktojë anëtarin brenda periudhës sa më të shkurtër.
- (2) Në rast të mungesës së kuorumit të komisionit zgjedhor, për shkak të mos përcaktimit të nominimit, kryetari i komisionit zgjedhor ka të drejtën të marr vetë vendime.



Neni 18

- (1) Në komisionin zgjedhor, duhet të jenë prezent kryetari plus së paku edhe dy anëtarë që të ketë kuorum. Komisioni i fakultetit duhet ta ketë të pranishëm kryesuesin dhe së paku një anëtarë më shumë për të arritur kuorumin.
- (2) Në rast se mungon kuorumi, kryetari mund të thërras një takim tjetër brenda 48 orësh.
- (3) Në rast se mungon kuorumi gjatë dy takimeve të njëpasnjëshme, kryetari e gëzon të drejtën e marrjes së vendimeve për temat e rendit të ditës.
- (4) Vendimet e komisionit zgjedhor dhe komisionit të fakultetit merren me shumicë votash.
- (5) Në rast të votimit të barabartë vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 19

- (1) Kryetari obligohet që ta ftojë mbledhjen e komisionit zgjedhor në afatin e paraparë sipas kësaj rregulloreje, më së voni një javë pasi të njoftohen për rastin përkatës.
- (2) Thirrja (ftesa) duhet t'i dorëzohet anëtarëve më së voni tri ditë para takimit. Hapat e duhur të komunikimit duhet të përdoren. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës.
- (3) Secili anëtarë i komisionit zgjedhor ka të drejtë t'ia parashtojë kërkesën kryetarit për të bërë thirrjen e takimit, duke dërguar me shkrim një argument dhe një rend të ditës. Takime të tilla duhet të thirren brenda tri ditëve pasi të bëhet kërkesa që është dërguar.

Neni 20

- (1) Procesverbali i takimit duhet të përgatitet për çdo takim të komisionit zgjedhor dhe të komisionit të fakultetit. Duhet të përdoret formulari i Protokolit.
- (2) Procesverbali duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të progresit të takimit dhe të vendimeve që janë marrë. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezent të komisionit. Në rast se refuzohet nënshkrimi, emri i anëtarit dhe arsyet duhet të jepen dhe të i bashkëngjiten procesverbalit.
- (3) Të gjitha procesverbalet e takimeve nga komisioni zgjedhor dhe të komisionit të fakultetit duhet të ruhen nga kryetari përkatës i komisionit zgjedhor. Nga një kopje për secilin takim duhet t'i jepet Sekretarit të Përgjithshëm të UKZ-së dhe duhet të ruhet në arkivin e UKZ-së për një periudhë prej katër vjetësh.



Neni 21

- (1) Takimi i komisionit të fakultetit duhet të thirret në bashkëpunim me kryetarin e komisionit zgjedhorë dhe kryetarin të komisionit të fakultetit.
- (2) Për udhëheqjen e takimeve të komisionit të fakultetit, rregullat përkatëse të kësaj rregulloreje për komisionin zgjedhor do të jenë të vlefshme.

Neni 22

- (1) Komisioni zgjedhor ka këto përgjegjësi:
 1. Përcaktimin dhe zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve
 2. përgatitjen e listave për zgjedhje të personave me të drejtë zgjedhjeje;
 3. vendimet rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
 4. Konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
 5. Vlerësimi i listës së kandidatëve;
 6. kryesimi i procedurave zgjedhore;
 7. verifikimi i identitetit i të votuesve;
 8. konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 9. dhënia e mandatit për ti pranuar organizatat dhe kandidatët me të drejtë zgjedhjeje.
 10. informimi i kandidatëve;
 11. shpallja e rezultateve të zgjedhjes;
 12. ndërrimi i mandatit;
 13. konstituimi i parlamentit të studentëve;
 14. konstituimi i këshillave të studentëve.
 15. koordinimi i komisioneve të fakulteteve
- (2) Lista e organizatave të pranura të studentëve dhe listat e kandidatëve duhet të shpallen publikisht më së voni 14 ditë para ditës së zgjedhjeve.
- (3) Rezultatet e zgjedhjeve duhet të shpallen publikisht brenda 2 ditëve pas ditës së zgjedhjeve. Mandatet duhet të caktohen në kohë të njëjtë.

Neni 23

- (1) Rektori dhe Dekanët e UKZ-së janë të obliguar t'ia sigurojnë me kërkesë të komisionit zgjedhor listën e përfunduar dhe me të gjitha ndryshimet të studentëve që kanë të drejtë të votojnë, më së voni 10 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve të studentëve nga Këshilli Drejtues.
- (2) Studentët me të drejtë votë duhet të i përmbushin këto dy kualifikime si në vijim:
 - Të kenë statusin e studentit të rregullt / korrespondencë.



- Të kenë kartelën i cili dëshmon që studentit është i regjistruar dhe i cili është i vlefshëm për datën kualifikuese të zgjedhjeve ashtu si definohet nga Këshilli Drejtues.
- (3) Data kualifikuese për listën e studentëve që kanë të drejtë të votojnë do të caktohet 15 ditë para zgjedhjeve.
 - (4) Lista e studentëve që kanë të drejtë të votojnë duhet të bëhet publike dhe të jetë e qasshme për komisionin zgjedhor brenda 14 ditëve pasi që zgjedhjet të jenë shpallur nga Këshilli Drejtues deri në 7 ditë para zgjedhjeve.
 - (5) Brenda kësaj periudhe secili studentë ka të drejtë të ankohet kundër përmbajtjes së listës përmes deklaratës me shkrim e cila mund t'i paraqitet kryetarit të komisionit të zgjedhjeve.
 - (6) Kundërshtimet kundër listës së studentëve me të drejtë vote duhet të paraqitën më së voni 14 ditë para zgjedhjeve dhe duhet të vendosët për ato kundërshtime me së voni 7 ditë para zgjedhjeve;

Lista e kandidatëve

Neni 24

- (1) Organizatat e studentëve me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje për parlament studentor apo këshilla të studentëve sipas parimeve të kësaj rregulloreje duhet të dorëzojnë listat e kandidatëve në komisionin zgjedhor më së voni 14 ditë para zgjedhjeve, duke përdorë formularin e Listës së Kandidatëve ashtu siç është paraqitur në bashkëngjitjen 2. Pasi të dorëzohet lista te komisioni zgjedhor, ajo nuk do të ndryshohet më.
- (2) Secila listë e kandidatëve duhet të përmbajë:
 - Emrin e organizatës të studentëve që bën fushatë;
 - Organin qeverisës që do të zgjidhet, (parlamentin studentor apo këshillin e studentëve);
 - Listën prioritare të kandidatëve;
 - Deklaratën e marrëveshjes së kandidatëve;
 - Përcaktimi i të adresuarit të autorizuar të organizatës studentore;
- (3) Në rast të emrave kontradiktor të dy apo më shumë organizatave të ndryshme studentore, komisioni zgjedhor duhet të kërkojë nga të adresuarit e autorizuar të secilës organizatë të përfshirë që të gjejnë një zgjedhje së paku 14 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në rast se nuk gjendet ndonjë marrëveshje deri në atë datë, komisioni zgjedhor duhet të vendosë dallimin e termeve për secilën organizatë të përfshirë.



- (4) Organizatat studentore, të cilat kanë qenë të përfaqësuara edhe më parë në përfaqësimin e studentëve të UKZ, do të kenë të drejtën ti mbajnë emrat e tyre.
- (5) Përdorimi i emrave të partive politike ekzistuese të Kosovës, si emra të organizatave të studentëve nuk do të lejohet.

Neni 25

- (1) Lista e kandidatëve e organizatave studentore duhet të përbëhet prej maksimumit, sa dyfishi i aq kandidatëve të numrit të përgjithshëm të po aq mandateve të lejueshme që të zgjidhet një organ (trup). Kandidatët tepricë duhet të hiqen prej listës nga komisioni zgjedhor.
- (2) Për secilin kandidat, që duhet të përmbushë kualifikimin sipas nenit 23 (2), informacionet (të dhënat) si në vijim duhet të ofrohen, në mënyrë që kandidatura të jetë e ligjshme.
 - Emri (at) dhe Mbiemri
 - Vendi i lindjes
 - Data e lindjes
 - Adresa
 - Titulli i studimeve aktive – fakulteti dhe departamenti
 - Numri i indeksit të studentit
 - Dëshmia e regjistrimit të studentit të rregullt – vula
 - Deklarata e miratimit (pëlqimit)
- (3) Kandidatët të cilët nuk i përmbushin këto kualifikime për të pasur të drejtë vote sipas nenit 23 paragrafi (2), komisioni zgjedhor duhet të hiqen nga lista e kandidatëve.

Neni 26

- (1) Prej 80% të kandidatëve të parë në listën e kandidatëve, së paku 40 % duhet të jenë meshkuj dhe 40% duhet të jenë femra, nga një kandidatë nga të dy gjinitë së paku njëherë në secilin grup prej tre/i kandidatëve, duke i llogaritur që nga kandidati i parë i listës.
- (2) Për detaje tjera të rregullativave dhe nevojave gjinore të listës së kandidatëve mund të i referoheni Ligjit për Barazi Gjinore nr.2004/2.



Neni 27

- (1) Vlefshmëria e listës së kandidatëve duhet të kontrollohet nga komisioni zgjedhor menjëherë pasi të merret.
- (2) Në rast të parregullsive apo të metave të cilat kërkojnë përmirësim, lista e kandidatëve duhet të kthehet mbrapa te i adresuari i autorizuar i organizatës studentore përkatëse, me shpjegimet e nevojshme për përmirësim.
- (3) Lista e përmirësuar e kandidatëve duhet të dorëzohet te komisionin zgjedhor nga organizata studentore më së voni 10 ditë para zgjedhjeve.
- (4) Nëse lista zgjedhore apo lista e kandidatëve, e cila është kthyer për përmirësim, nuk dorëzohet brenda periudhës kohore të caktuar, kandidatura e organizatës përkatëse studentore njihet si e tërhequr.

Neni 28

- (1) Secila organizatë studentore do të ketë të drejtën të tërheqë kandidaturën e saj apo individit që kandidon përmes deklaratës me shkrim, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga i adresuari i autorizuar dhe udhëheqësi i organizatës studentore, me së voni 10 ditë para zgjedhjeve.
- (2) Kandidatura e organizatës studentore do të njihet si e tërhequr, nëse numri i kërkuar i kandidatëve sipas kësaj rregulloreje nuk është dhënë për arsye se kandidatët kanë tërhequr kandidaturën me shkrim dhe deklaratë të nënshkruar, më së voni 10 ditë para zgjedhjeve.
- (3) Çertifikimi i listës së kandidatëve do të bëhet në bazë të listës prioritare të kandidatëve nga Organizatat Studentore.

Neni 29

- (1) Lista zgjedhore apo lista e kandidatëve e cila dorëzohet jashtë periudhës së caktuar duhet të mos njihet.
- (2) Për vlerësimin e datës së saktë të dorëzimit, data e pullës postare apo data e dorëzimit personal do të jetë vendimtare.
- (3) Kryesuesi i komisionit zgjedhor është i obliguar dhe duhet të aranzhojë në periudhën para zgjedhjeve një fushatë informuese për studentët me të drejtë vote, duke i



informuar për procedurat zgjedhore. Rektori është i obliguar të ofrojë resurset e nevojshme për një proces të tillë zgjedhor dhe të njëjtat ti bëjë publike.

Mbajtja e zgjedhjeve

Neni 30

- (1) Qendrat e vendvotimeve në të gjitha njësitë akademike hapen në ora 7.00 dhe mbyllen në ora 19.00, përjashtimisht nga kjo nëse në kohën e mbylljes së vendvotimeve ka radhë të votuesve atëherë koha e mbylljes së vendvotimit shtyhet deri në votimin e studentit të fundit.
- (2) Totali prej 12 orëve duhet të jetë në dispozicion për votim.
- (3) Numrin e vendvotimeve nëpër fakultete e cakton komisioni zgjedhor.

Neni 31

- (1) Rektori është i obliguar që të ofrojë vend votime të përshtatshme zgjedhore për mbajtjen e zgjedhjeve në secilën ndërtesë të fakultetit. Pajisjet e nevojshme, siç janë kutit e votimit, kabinat e votimit dhe pajisje tjera të nevojshme për votim duhet të ofrohen nga Rektori me kërkesë të komisionit zgjedhor.
- (2) Gjatë procesit të zgjedhjeve, në vend votime mund të kenë qasje përveç anëtarëve të komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit), personat si në vijim:
 - Personeli mbështetës i komisionit zgjedhor
 - vëzhguesit zyrtar të caktuar për zgjedhje
 - votuesit
 - personeli tjetër i caktuar zyrtar, përgjegjës për funksionim të rregullt
- (3) Pasi vota të jetë hedhur, votuesit duhet të largohen nga vend votimi pa vonesë.
- (4) Nëse paraqitet si e nevojshme për arsye të funksionimit të rregullt të procedurës zgjedhore, kryesuesi i komisionit zgjedhor (komisioni i fakultetit) do të ketë të drejtën të kufizoj qasjen e votuesve në vetëm nga një votues sipas radhës.

Neni 32

- (1) Secili vend votim duhet të ketë së paku një kabinë votimi. Numri i përgjithshëm i kabinave të votimit që është i nevojshëm për secilin fakultet duhet të kalkulohet në atë mënyrë që 80% e studentëve me të drejtë vote të kenë mundësi ti hedhin votat pa e vështirësuar periudhën votuese.



- (2) Kabina e votimit duhet të vendosët në atë pozicion në mënyrë që votuesi të mos jetë i vëzhguar nga persona të tjerë që janë të pranishëm në vendvotim gjatë procedurës së votimit.
- (3) Në rast se nuk ofrohen kabina të vendosura dhe të ndërtuara për votim, duhet të adaptohet një pjesë e mjaftueshme e dhomës në mënyrën e përshtatshme. Këto rregullime të përkohshme duhet të pranohen nga komisioni zgjedhor bazuar në inspektim individual.
- (4) Kabina e votimit duhet të përmbajë tavolinën me ulëse të lartë apo me banak të lartë. Duhet të ketë dritë të mjaftueshme dhe duhet të ofrojë material për shkrim për të bërë votimin në fletë votim.

Neni 33

- (1) Fletë votimet e ndryshme duhet të dallohen përmes ngjyrës
- (2) Fletë votimet duhet të palosën së paku njëherë para se të hedhën në kutin e votimit.

Neni 34

Komisioni zgjedhor (komisioni i fakultetit) është përgjegjës për mbajtjen e procedurave zgjedhore në pajtueshmëri me rregulloren për zgjedhje.

Neni 35

- (1) Votimi duhet të bëhet në formë personale. Të verbrit, personat me aftësi të kufizuara, nga të cilët nuk pritët që të mund të votojnë në mënyrë vetanake, duhet të kenë të drejtën të zgjedhin një person përcjellës, i cili do të mbështes ata / ato gjatë procedurës së zgjedhjes.
- (2) Përveç përjashtimit nga paragrafit (1) të këtij neni, në kabinën e votimit mund të hyjë vetëm nga një person sipas radhës.

Neni 36

- (1) Secili votues është i obliguar ta dëshmojë identitetin e tij / sajë para komisionit zgjedhor
- (2) (komisionit të fakultetit) përmes paraqitjes së ID- kartelës.
- (3) Vlerësimi i pranueshmërisë duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të listës zgjedhore për personat që kanë të drejtë votimi.



Neni 37

- (1) Secili student me të drejtë vote duhet të dëshmojë identitetin ashtu si u përshkrua më lartë.
- (2) Kryesuesi i komisionit zgjedhor (komisioni i fakultetit) ia jep në dorë fletën votuese të duhur studentit.
- (3) Secili student me të drejtë vote ka të drejt të votoj për:
 - a. parlamentin studentor të universitetit
 - b. këshillat e studentëve në të gjitha fakultetet aty ku ai/ajo është listuar si student me të drejtë vote.
- (4) Kryesuesi i komisionit zgjedhor (komisioni i fakultetit) drejton votuesin për të hyrë në kabinën e votimit.
- (5) Votuesi e mbush fletë votimin, e palos njëherë dhe del jashtë kabinës së votimit.
- (6) Kryesuesi i komisionit zgjedhor tërheq mbulesën e kutisë së votimit dhe votuesi e fut fletë votimin e palosur në kuti të votimit.
- (7) Në rast se ndodh ndonjë gabim nga votuesi gjatë mbushjes në fletë votim, komisioni zgjedhor (komisioni i fakultetit) është i obliguar të ofrojë edhe një fletë votim për votuesin me kërkesën e votuesit. Fletë votimi paraprak duhet të grisët nga votuesi para dorëzimit në prani të komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit).
- (8) Dorëzimi i fletëvotimit shtesë duhet të regjistrohet në protokollet e votimit.

Neni 38

- (1) Emri i votuesit i cili ka hedhur votën, duhet të regjistrohet në regjistrin e votimit nga një anëtarë i komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit). Formulari i bashkangjitur 4 për Regjistrimin e Votimeve i kësaj rregulloreje duhet të përdoret.
- (2) Emri duhet të regjistrohet me numrin sipas rreshtit dhe me numrin origjinal të listës së votuesve me të drejtë vote.
- (3) Anëtari tjetër i komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit) duhet të evidentoj emrin e votuesit në listën e votuesve me të drejtë vote.

Neni 39

Mënyra e konfirmimit të votuesit bëhet nga një anëtar i komisionit zgjedhorë (komisionit të



fakultetit).

Neni 40

- (1) Në rast të dyshimit sa i përket identitetit të studentit, komisioni zgjedhor ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë të identifikimit.
- (2) Nëse identiteti nuk mund të qartësohet, studenti nuk lejohet të votojë.
- (3) Pasi të dorëzohet fletë votimi, asnjë dyshim tjetër sa i përket identitetit të votuesit nuk është i lejueshëm ligjërisht.

Neni 41

- (1) Për fletë votim mund të përdoret formulari i Fletë Votimit sipas të bashkangjiturës 5 të kësaj rregulloreje. Fletë Votimet duhet të përmbajnë informacione në të tri gjuhët zyrtare në Kosovë (Shqip, Anglisht dhe Serbisht).
- (2) Varësisht nga organi që do të zgjidhet, mund të përdoren ngjyra të ndryshme të fletë votimeve ashtu siç do të vendosët nga komisioni zgjedhor.
- (3) Renditja e organizatave studentore në fletë votim duhet të përcaktohet përmes hedhjes së shortit (lotarisë) e cila mbahet nga komisioni zgjedhor.
- (4) Shtypja e fletë votimeve duhet të aranzhohet nga kryesuesi i komisionit zgjedhor në kohën e duhur dhe pasi të shpallën listat zgjedhore.

Neni 42

Fletë votimi njihet si i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të pa diskutueshme për organizatën studentore apo kandidatin të cilin votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi markon qarkun në të majtë të emrit të organizatës së pranueshme apo kandidatit me një iks (x) apo shenja tjera të kësaj natyre, në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur këtë organizatë apo kandidatë tregohet me qartësi.

Neni 43

- (1) Fletë votimi njihet si i pavlefshëm, nëse:
 1. Përdorët edhe një fletë votim përveç fletë votimit të rregullt
 2. Atëherë kur fletë votimit i shqyhet një pjesë në atë mënyrë që nuk do të ketë mundësi të qartësohet se cila organizatë studentore apo kandidatë është zgjedhur
 3. Atëherë kur asnjë organizatë studentore apo kandidatë nuk është markuar



4. Atëherë kur dy apo më shumë organizata studentore apo kandidatë janë markuar.
 5. Atëherë kur markimet apo shenjat në fletë votime janë bërë në atë mënyrë që nuk mund të vërehet asnjë përcaktim të një organizatë studentore apo kandidatë dhe nga e cila nuk mund të nxirret asnjë përfundim.
- (2) Fjalët, komentet apo shenjat tjera të cilat markohen në fletë votim, nuk e çrregullojnë vlefshmërinë e fletë votimit, përveç nëse është e ngjashme dhe rrjedh nga rastet e renditura më lartë.

Neni 44

- (1) Pasi që periudha zgjedhore prej 12 orëve të përfundoj, kryesuesi i komisionit të zgjedhjeve (komisioni i fakultetit) deklaron përfundimin e votimeve. Vend votimi duhet të mbyllet vetëm nga anëtarët e komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit), personelit mbështetës dhe vëzhguesve të cilët mbesin në dhomë.
- (2) Komisioni zgjedhor (komisioni i fakultetit) duhet t'i përziej fletëvotimet në kutin e votimit, pastaj i zbrazë dhe i numëron:
 1. Numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve për secilin organ të hedhura nga votuesit
 2. Numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në regjistratorët e votimeve
 3. Në rast të mos përputhjes së rezultateve sipas pikës 1 dhe 2 të këtij paragrafi, identifikoni arsyet e kësaj mospërputhjeje
- (3) Komisioni zgjedhor (komisioni i fakultetit), shpalos fletë votimet, i rregullon ato sipas organit të pranueshëm, kontrollon vlefshmërinë, identifikon fletë votimet e pavlefshme sipas numrit të radhës dhe e përcakton:
 1. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura.
 2. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të pavlefshme
 3. Numrin e përgjithshëm të votave të hedhura të vlefshme
 4. Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme për secilën organizatë studentore apo kandidat
- (4) Rezultatet sipas pikës (3) të këtij Neni duhet të transferohen te kryesuesi i komisionit zgjedhor pa vonesë.

Neni 45

- (1) Komisioni zgjedhor (komisioni i fakultetit) duhet të protokolloj procedurën zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve në një raport. Për protokoll duhet të përdoret formulari i Protokollit të Procedurës së Zgjedhjeve sipas të bashkangjiturës 6 të kësaj rregulloreje.
- (2) Raporti duhet të përmbaj si në vijim:
 1. Emrin e vend votimit dhe datën(at) e votimit



2. Emrat e anëtarëve prezent
 3. Emrat e vëzhguesve prezent
 4. Numrin e saktë të fletë votimeve të dorëzuara për secilin organ që është në zgjedhje
 5. Koha e fillimit dhe e mbarimit e periudhës së zgjedhjeve
 6. Vendimet potenciale të komisionit të zgjedhjeve (komisionit të fakultetit) sa i përket lejimit apo mos lejimit të votuesve për votim.
 7. Vendime tjera të komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit) gjatë periudhës së zgjedhjeve (p.sh. pengimet gjatë periudhës së zgjedhjeve, votimet përmes përcjelljes mbështetëse të ndonjë personi etj.)
- (3) Të bashkangjiturat si në vijim duhet ti shtohen këtij raporti:
1. Listën e votuesve me të drejt vote
 2. Regjistrin e votimit
 3. Votat e pa vlefshme, të ndara, paketuara dhe të markuar për secilin organ apo kandidat që është në zgjedhje
 4. Votat e vlefshme, të ndara, paketuara dhe të markuar për secilin organ apo kandidat që është në zgjedhje
 5. Fletë votimet e pa shfrytëzuara, të ndara, paketuara dhe ta markuar.
- (4) Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit) dhe vëzhguesve. Në rast të refuzimit të nënshkrimit, arsyet duhet të regjistrohen.
- (5) Raporti plus format e bashkangjitura për procesin e zgjedhjeve.

Neni 46

- (1) Në rast të rrethanave të veçanta apo incidenteve përreth komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit), komisioni zgjedhor ka të drejtë të ndërpres periudhën zgjedhore dhe të shtyjë në një ditë tjetër zgjedhore.
- (2) Secila shtyrje e zgjedhjeve duhet të shpallet në publik pa vonesë nga kryesuesi i komisionit zgjedhor (komisioni i fakultetit).
- (3) Nëse periudha votuese vetëm ka filluar dhe pastaj pengohet, të gjitha veprimet zgjedhore, fletë votimet dhe kutitë e votimit duhet të mbyllet nga kryesuesi i komisionit zgjedhor (komisionit të fakultetit) derisa procedura zgjedhore të vazhdohet.

Neni 47

- (1) Shpërndarja e mandateve duhet të kalkulohet nga komisioni zgjedhor në pajtueshmëri me rregullat e kësaj rregulloreje.



- (2) Për shpërndarjen e mandateve, një formular për Dhënin e Mandateve sipas të bashkangjiturës 7 të kësaj rregullore duhet të përdoret.

Neni 48

- (1) Rezultati i zgjedhjeve duhet të publikohet nga kryesuesi i komisionit zgjedhor pa vonesë, më së voni deri 4 ditë pas ditës së zgjedhjeve.
- (2) Shpallja duhet të përmbajë:
1. Rezultatin e zgjedhjeve në shifra, të renditur sipas organizatës studentore dhe kandidatit
 2. Numrin e përgjithshëm të mandateve për secilën organizatë studentore të pranueshme
 3. Listën e kandidatëve për secilin organ.

Neni 49

- (1) Mandatorët e zgjedhur duhet të informohen nga kryesuesi i komisionit zgjedhor brenda dy ditësh pasi të jetë shpallur rezultati zgjedhor.
- (2) Për letrën informuese mund të përdoret formulari për Njoftimin e Mandatarëve sipas të bashkangjiturës 8 të kësaj rregulloreje.
- (3) Mandati duhet të njihet si i pranuar, nëse mandatori nuk e kundërshton zgjedhjen e tij brenda katër ditëve pasi që rezultati i zgjedhjeve të jetë shpallur.
- (4) Në rast të kundërshtimit të mandatit nga mandatarin, mandati duhet të caktohet kandidatit përcjellës sipas listës së kandidatëve.
- (5) Mandati duhet të njihet i papranuar në rast se organizata studentore nuk pajtohet me përfaqësimin e kandidatit të caktuar në organin përkatës dhe me arsyetimin e kërkon zëvendësimin e tij.

Neni 50

- (1) Kundërshtimet kundër procedurave dhe rezultateve të zgjedhjeve të studentëve duhet të dorëzohen te komisioni i zgjedhjeve brenda dy javëve pasi të jenë shpallur rezultatet e zgjedhjeve.
- (2) Kundërshtimet për arsye të shkeljeve të rregullave të kësaj rregulloreje duhet të vendosen nga Këshilli Drejtues i Universitetit brenda katër javësh pas pranimit të kundërshtimeve.



- (3) Ankesat eventuale të studentëve dhe organizatave studentore ndaj rezultateve zgjedhore, shqyrtohen dhe vendosen nga komisioni zgjedhor brenda 8 (tetë) ditësh pas pranimit të tyre.
- (4) Në rast se zgjedhjet deklarohen të pavlefshme, zgjedhjet e tjera duhet të mbahen dhe caktimi i mandateve duhet të suspendohet.
- (5) Çdo ndryshim në rezultatin e zgjedhjeve për arsye të pranimit të ankesave duhet të shpallet publikisht nga kryesuesi i komisionit zgjedhor.
- (6) Kundër vendimit përkatës të Komisionit Zgjedhor dhe të Këshillit Drejtues, ankesa mund të parashtrohet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kundër vendimit të Masht-it, asnjë mjet ligjor për korrigjim nuk është i lejueshëm.

Neni 51

- (1) Nëse zgjedhjet duhet të përsëriten për arsye të ankesave të bazuara dhe të pranuara, zgjedhjet duhet të mbahen brenda 60 ditëve pasi që vendimi të jetë i vlefshëm. Ditët e pushimeve duhet të hiqen nga ky kalkulim i kësaj periudhe.
- (2) Zgjedhjet nuk duhet të përsëriten gjatë periudhës së pushimit.
- (3) Për zgjedhjet e përsëritura, lista origjinale e zgjedhjeve dhe lista e kandidatëve duhet të përdoren.

Neni 52

- (1) Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Drejtues.
- (2) Për të gjitha aspektet të cilat nuk rregullohen me këtë rregullore duhet t'i referoheni Statutit të UKZ dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
- (3) Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, ç'fuqizohet rregullorja e mëparshme për zgjedhjet studentore, nr.01/432 dt. 20.03.2015.

Shtator, 2017



Kryetar i Këshillit Drejtues
Akadëmik Fejzullah Krasniqi